

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

NACIONAL

Drejtor:
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com



Si po fiton Partia Demokratike?

Nga Miranda Haxhia

Asnjë forcë tjetër politike nuk e ka fyer Beratin më shumë se e Majta e cila që me emrin që i ka vënë gjithë popullit të Beratit, duke e quajtur zonë e Majtë, i nominon si tuftë e

faqe 6



Radio "Nacional" lidër në tregun radifonik shqiptar

Radio "Nacional" qysh në çastet e para të fillimit të punës ka ofruar me kujdes të veçantë muzikën shqiptare, popullore e të lehte, por dhe krijimet alternative në rryma e stile të ndryshme. Radio "Nacional" është themeluar me iniciativën e zotit Flamur Buçpapaj, një njeri kurajoz dhe më shumë ide të

faqe 16

PRÇARJA E TE MAJTES PAS 28 QERSHORIT

Nga Arben Berisha- New York

Pas zgjedhjeve të 28 Qershorit 2009, politika e majtë shqiptare mund të pësojë disa ndryshime drastike në sferat e lidershipit politik dhe formimin e forcave të reja politike.

faqe 3

RRUGA DURRËS - MORINË

Nga Kim Mehmeti, Shkup

Shqiptarët e Maqedonisë e dinë se ka kritikuesit të ndërtimit të rrugës Durrës-Morinë, të cilët, duke shtruar pyetje për kinse keqpërdorimet që janë bërë gjatë ndërtimit të kësaj rruge ...

faqe 4

RRETH BASHKIMIT TË SHQIPËTARËVE

Nga Nazmi Lukaj -Prishtinë

Rruga-Durrës -Qafë Morinë, edhe atë pak largësi që ekzistonte mes Tiranës e Prishtinës, do ta zhdrukë...

faqe 2

ÇMENDURIA SHOVENTE PËR HIMARËN

Nga Musa Tartari

Për Himarën kanë shkruar shumë dijetarë realistë, por asnjëri nuk e ka quajtur kurrë territor grek. Edhe Barleti në veçanti mburr himariotët (Topiajt), që sundonin Himarën.

faqe 5

PIKËPYETJET E MARRËVESHJES SË OHRIT

Këte premtën maren vendim pune 46 administratorë me përvojë pune, të cilët kanë konkurruar në konkursin e dytë dhe të tretë

faqe 4

BUJANI DHE LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

Nga Hasan Mehmeti

faqe 19

Intervistë e shkrimtarit të shquar shqiptar marrë nga poeti Gjekë Marinaj

Kadare: Tre përkthyesit e mij më të mirë...

faqe 10-11



Gjithçka rreth shkrimtarit nobelist Othman Pamuk

faqe 17

Intervista me artistë të shquar Shqiptarë

Teuta Thaçi : Zotin kam në krah

Eli i Cajës: Jam këshilltar i vetvetes

Illir Hyseni: Këndoju për Pavarsinë e Kosovës

Kedi i Gjenës: Së shpejti në Amerikë

faqe 23



R. Bulku: Imazhi i PD në zgjedhjet e 28 Qershorit

faqe 22



Intervistë me Nënkryetarin e AAK, Ahmet Isufi

faqe 21

Në BRENDESI

Frika nga Atdheu

faqe 8-9

Poezi nga Skënder Buçpapaj

Sinteza e mendimit

faqe 12

Kritikë nga Dr. Hysen Matoshi

Josif Bageri

faqe 14

Studim nga Dr. Avzi Mustafa

Gishtat e gjelbërimit

Poezi nga Muhamet Kërveshi

faqe 21

Fyelli Magjik

Tregim nga Gani Mehmetaj

faqe 18

E fshehta Hoxha - Kupi

Dossier nga Dr. Bajram Xhafa

faqe 20

Proza e Qazim Shehut

Nga Kastriot Caka

faqe 13

Vajza e Luanit

Roman nga Lorreta Chase

faqe 13

Gjilani

Reportazh nga Evelinë Sefiu

faqe 7


Reportazh nga Mali i Zi

Ishte e mërkurë. Saktësisht, ishte 22 prilli i këtij viti. U

faqe 7

Kadare flet për rolin e përkthyesve në famen perbotshme të veprës së tij

Ju rrëfej tre përkthyesit e mij më të mire



Ismail Kadare (l. 1936) është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës. Ai është përkthyer në mbi 30 gjuhë të huaja dhe ka pranuar çmimin prestigjioz Man Booker International Prize. Një numër i konsiderueshëm i veprave të tij është përkthyer në anglisht nga frëngjishtja. Gjatë më se katër dekadave të regjimit totalitar në Shqipëri, intuïta e thellë e Kadaresë dhe kuptimi thelbësor i situatës politike prej tij, u kthye në parametra sigurie për shkrimtarët dhe lexuesit në Shqipëri. Shumë njerëz i japin merita Kadaresë që diti ta ruaj popullin shqiptar nga hyrja e parakohshme në revolucion politik. Sidoqoftë, kur koha që e përshatshme, në vitin 1990, Kadareja iku nga regjimi komunist dhe kërkoi azil politik në Francë, akt ky që u kthye në një sinjal politik për popullin shqiptar të bënte lëvizjen e parë të organizuar drejt demokracisë. Në këtë aspekt, mund të thuhet se Kadareja ka dy lloj lexuesish. Të parët janë ata që mbajnë vëmendjen tek ai për udhëzime politike dhe kulturore. Kurse të dytët i përkasin atij grupi që shohin tek Kadareja përbërësin e një shkrimtari internacional që i ka dhënë trajtë letërsisë botërore të shekullit XX-të.

Nga Gjekë Marinaj



GJEKE MARINAJ: A do të ishit dakord me mendimin e përgjithshëm se përkthyesit e letërsisë tuaj kanë luajtur një rol të rëndësishëm në pasqyrimin e vlerave të tua si shkrimtar në arenën ndërkombëtare? Në ç'shikallë e ndani suksesin tuaj me ta?

ISMAIL KADARE: Për çdo shkrimtar që bëhet i njohur në shkallë botërore, përkthyesit lozin, pa dyshim, një rol të pazëvendësueshëm. Sepse nuk njihet një formë tjetër e transmetimit të vlerave letrare përveç përkthimit.

Përkthyesit, si shumë gjëra në këtë botë, mund të jenë të shkëlqyeshëm, të mesmë, ose të dobët. Në bazë të kësaj hierarkije përcaktohet edhe roli i tyre për njohjen e shkrimtarit të përkthyer. Me fjalë të tjera, përsa i përket përkthimit, shkrimtari i përkthyer mund të jetë me shumë fat, thjesht me fat, ose pa fat.

Unë e kam quajtur veten përgjithësisht me fat.

GM: Ngaqë ju mendoni kështu, atëherë më lind një pyetje tjetër: cili është mendimi juaj rreth pagesës (Royalties) së përkthyesve, a do të jetë mirë që ata të paguhen vetëm një herë për punën që kryejnë, apo meritojnë një përqindje të shitjes së librit për sa do gjatë që vepra të vazhdojnë të jetë në treg?

IK: Mendoj se do të ishte më e logjikshme që sistemi i shpërblimit të përkthyesve të përbëhej nga dy elemente: një shumë fillestare afrofé, sipas kontratës, plus, në rast të shitjes së suksesshme, një përqindje mbi shitjen. Shuma e parë është e domosdoshme sepse, ndryshe nga një autor, asnjë përkthyes nuk mund të punojë pa një garanci fillestare. Kurse pagesën sipas shitjes do ta quaja një pagesë „të gëzueshme”, përderi sa konfirmon suksesin.

Çdo përkthim ka qenë për mua një akt miqësie

GM: Asnjë shkrimtar tjetër shqiptar nuk është përkthyer në aq gjuhë të huaja sa ti. Në të njëjtën kohë edhe ju keni përkthyer një numër të konsiderueshëm autorësh nga disa gjuhë të huaja në shqip. Cilat janë disa nga sfidat e përbashkëta të artit të përkthimit në një gjuhë tjetër dhe të artit të shkruarit në gjuhën tënde?

IK: Të shkruarit është në përgjithësi një sfidë e shuamëanshme. Njëra nga sfidat ka lidhje me gjuhën. Çdo shkrimtar kur shkruan vihet në raporte komplekse me gjuhën e vet. Përdora fjalën „komplekse” sepse raportet mund të jenë herë harmonioze, herë jo. Midis shkrimtarit dhe gjuhës

zhvillohet një proces i vazhdueshëm. Të dy palët përpriqen t'i bëjnë qëndresë njeri-tjetrit. Shkrimtari dëshiron që gjuha t'i shërbejë atij, në mënyrë sa më individuale (lexo: origjinale). Por gjuha ka ligjet e saj, që i ruan me fanatizëm. Lufta midis tyre është e lodhshme. Por, ndryshe nga çdo ndeshje tjetër, ajo është aq e veçantë saqë i ngjan luftës aq sa ç'i ngjan dhe dashurisë. Prej saj lindin veprat.

GM: Ajo që desha të mësoj prej teje është, kur ju shkruani në shqip për shembull, a shkruani me përkthimin në mendje, pra a mundoheni t'i ndërtoni fjalitë në një mënyrë që të jenë të përkthyeshme dhe pastaj të kuptueshme në çdo gjuhë tjetër që mund të përkthehen ato?

IK: Kurrsesi. Do të shtoja se nuk besoj se ka në këtë botë ndonjë shkrimtar serioz që e bën një gjë të tillë.

GM: Disa nga librat tuaj janë përkthyer nga shqipja në frëngjisht e nga frëngjishtja në disa gjuhë të tjera. Sa problematike është për cilësinë e një veprë letrare përkthimi nga një përkthim i dikujt tjetër?

IK: Përkthimet e mija kryesore, që janë gjer më sot edhe më të mirat, në gjermanisht, në frëngjisht dhe në spanjisht, janë bërë direkt nga origjinali shqip. Në anglisht janë bërë një pjesë nga origjinali, e një pjesë nga frëngjishtja. Në gjuhët e tjera ndodh e njëjta gjë: afërsisht gjysma janë nga origjinali shqip, e gjysma nga gjuhë të tjera, më tepër nga frëngjishtja.

GM: Kur ju përktheni nga gjuhët e tjera në shqip, si e bëni përzgjedhjen, cilat janë disa nga kriteret që ju kërkoni te një vepër letrare para se të 'ia dedikoni kohën dhe vëmendjen tuaj asaj veprë?

IK: Përkthimet e pakta që kam bërë, kanë patur veç një shtysë: kënaqësinë. S'kam qenë kurrë i

detyruar të përkthej qoftë edhe dy vargje ose disa radhë proze, për një tjetër arsye.

Libri im i fundit që botova përpara se ta lë Shqipërinë komuniste më 1990, "Ftesë në studio", ka një frymë lamtumire dhe, bashkë me të, një frymë si prej testamenti. Isha gati i sigurt se lamtumira ishte e përkohshme, magjithatë, përderi sa "të nisesh për diku, është pakëz vdekje" (partir c'est un peu mourir), kjo frymë ishte e pashmangshme.

Libri „Ftesë në studio” ndahet në tri pjesë. Pjesa e parë, vjersha dhe poema, e dyta, përkthime dhe e treta, shënime të lirshme për artin dhe jetën. Pjesën e dytë e kam titulluar „Mysafirë në studio”. Pra, poetët e përkthyer i kam konsideruar mysafirë, bujtës, në shtëpinë time, çka për një shqiptar quhet nderimi më i lartë ndaj tjetrit. Duke qenë bujtës në studio, ata janë po aq të tillë në gjuhën shqipe. Dhe përderi sa kur fton dikë në shtëpinë tënde ti përpriqesh që ai të ndihet sa më mirë, në këtë rast, për kolegët e mi të ftuar unë kam treguar kujdesin maksimal që ata, në gjuhën shqipe, të ndihen sa më mirë. Shkurt, kam treguar për ta, ndoshta, më shumë kujdes artistik se ç'mund të kem treguar për veten time.

Çdo përkthim vetvetiu ka qenë për mua një akt miqësie. Kjo ka qenë e pandarë nga sfida e përkryerjes artistike. Kam vënë në provë veten time e, bashkë me të, gjuhën shqipe se sa e aftë është ajo „të presë miq”.

Shqipja është një makinë e mrekullueshme shprehjeje. Ajo përballon tekstet më të vështira e më trillane. Ekspertë shqiptarë dhe të huaj thonë se përkthimet e Shekspirit ose të Dantes në shqip janë ndër më të përsosurit. Zgjedhjet e mija në përgjithësi janë tekste të tilla, të vështira. Kur kam qenë student në Moskë kam përkthyer poemën më të bukur e njëkohësisht më të vështirën e Majakovskit „Re me pantallona”, duke respektuar me skrupulozitet teknikën e saj pothuajse

demoniake. Një tjetër përkthim, më saktë një ripërkthim, në trajtë prove e sfide, ka qenë „Orestia” e Eskilit. Kam dashur të provoj veten dhe gjuhën shqipe se a do ta'i jepja dot në përkthim dy nga tiparet e tij kryesore. E para, vargjet hijerënda të ndërhuara me kompozita po aq hijerënda, prej dy ose tri fjalësh, me të cilat, bashkëkohësit e tragjedianit, thoshin se ai „donte të trembte spektatorët. Në shumë gjuhë kjo hije e rëndë e madhështore zbehej ose humbte, jo veç për faj të përkthyesve. Meqenëse shqipja, ashtu si greqishtja e vjetër dhe gjermanishtja e ka lehtë përdorimin e togfjalëve, (kompozitave), falë kësaj cilësie të makinës gjuhësore, u bë e mundur ajo që thashë më lart. Vështirësia e dytë ishte ai ngjyrim mjegullor, thënë ndryshe, pjesa disi e errët, jo fort e shpjegueshme racionalisht, e shumë vargjeve të Eskilit. Disa herë duket se është detyrë e përkthyesve „ta sqarojnë” veprën. Unë mendoj se përkthyesi, ashtu siç duhet të japë besnikërisht qartësinë e shkrimtarit, po aq duhet të japë besnikërisht „paqartësinë” e tij. Kjo „paqartësi”, kjo mjegull, disa herë enigmatike, është e shpeshhtë në letërsinë antike. Ne nuk duhet të kemi frikë prej saj. Ajo bën pjesë në synimin transedental, një nga më të fismet e artit.

Vjersha të tjera si „Balada e të varurve” e François Vignon, ose „Anija e dehur” e Arthur Rimbaud janë bërë me të njëjtën synim. E kështu me radhë. Meqenëse kjo intervistë i kushtohet përkthimit, më lejoni të tregoj një kuriozitet. Siç e kam rrëfyer në „Ftesë në studio”, „Anijen e dehur” të Rimbaud-se, nga padurimi e kam përkthyer, më saktë e kam bërë në një version të ri përkthimi, kur nuk e zotëroja mirë frëngjishten. Kjo ka bërë që, përveç pasaktësive të tjera, dy vargje të strofës së nëntë të jenë përkthyer krejtësisht gabim. Teksti në frëngjisht:

Pareils à des acteurs de drames très – antiques,
Les flots roulant au loin leurs frissons de volets.

Që mund të përkthehet :

.....
.....
(teksti anglisht)
në gjuhën shqipe u be prej meje:

Si krisma në finale tragjedish antike,
Gjemshëm përplaseshin dallgët në kije.

Kur libri „Ftesë në studio” u përkthye në Francë, i syugjerova botuesit francez ta hiqte gjithë këtë

copë, por ai mendoj ta linte ashtu ngaqë e quajti një kuriozitet interesant. Dhe kështu, dy vargjet e Rembaud-së u botuan në frëngjisht!

Comme les finales grondants des tragédies antiques,
Les vagues bruyamment venaient battre la coque ;

E marr me mend që ihtarët e shumtë të Rimbaut-së do të kenë zënë kokën me duar !

GM: A mendon se librat e përkthyer duhet të kenë një hyrje nga përkthyesi ku ai të shpjegoi për lexuesin disa nga vështirësitë që ka përjetuar gjatë përkthimit dhe se si i ka zgjidhur ato për të rritur mundësinë e të kuptuarit të tekstit në përkthim?

IK: Kjo varet nga vepra. E natyrisht kjo varet nga përkthyesi. Gjithçka që ndihmon në një interpretim sa më të mirë të tekstit, mendoj se është e vlefshme.

Konsultimet me përkthyesin janë të nevojshme

GM: Një pjesë e mirë e romaneve të tua është e përkthyer nga përkthyes shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë. Kohët e fundit përkthyes të huaj si David Bello kanë filluar të tregojnë interes të veçantë në përkthimin e veprave të tua. Cili grup përkthyesish mendoni se mund të bëjë një përkthim më të saktë ata që njohin më mirë gjuhën nga e cila përkthejnë apo ata që njohin më mirë gjuhën në të cilën përkthejnë?

IK: Përkthyesi duhet t'i dijë mirë të dyja gjuhët. Por, ndërsa gjuhën nga e cila përkthen ai është i detyruar ta kuptojë shkëlqyeshëm, pa qenë i detyruar ta shkruajë mirë, gjuhën në të cilën përkthen detyrimisht duhet ta kuptojë e ta shkruajë në mënyrë të përsosur. Shkurt, guha në të cilën përkthyesi përkthen veprën luan rolin kryesor në këtë aventurë.

GM: Si i karakterizoni marrëdhëniet e tua me një përkthyes. Pra a bashkëpunoni ngushtë gjatë përkthimit apo e leni gjithçka në duart e përkthyesit duke i pranuar manovrimet e tij/saj me tekstin si pjesë e fatit të përkthimit i mirë apo i dobët qoftë ai?

IK: Mendoj se konsultimet me përkthyesin janë të nevojshme. Por si çdo gjë që s'duhet të teprohet edhe ato e kanë një kufi.

GM: Tek shkruanit nën mbikëqyrjen e rreptë të regjimit komunist, që shpesh here të ka nxjerrë mjaft telashe, jeni detyruar të përdorni një gjuhë alegorikë, specifike për lexuesin shqiptar. Si mund të përkthehet, fjala vjen "Dimri i madh", jo aspekti lingvistik i veprës, pro lakimi me të cilin është dhënë kjo lingvistikë letrare për të mënjeluar problemet që mund të sillte fonetika a drejtpërdrejtë e saj?

IK: Kjo është një temë tepër e gjerë për kuadrin e një interviste. Romani "Dimri i vietmisë së madhe" u përkthe dhe u botua në shumë vende europiane qysh në vitin 1978, kur diktatura shqiptare ishte në kulmin e egërsisë së saj. Romani u kuptua drejt nga lexuesit e botës së lirë, pavarësisht se ishte shkruar në një vend jo të lirë. Mendoj se lexuesi e kapi gjënë kryesore në këtë veprë: tablonë e përgjithshme të universit komunist. Ndërsa në letërsinë e realizmit socialist të vendeve Lindore ky univers përshkruhej me ngjyra të qeshura dhe optimiste, ky roman jepte një tablo krejt të kundërt: të zymtë, dëshpëruese, plot ankth. Mjafton t'ju kujtoj se në një pritje zyrtare të Shqipërisë komuniste shfaqej fantazma e një ministri të pushkatuar, me shenjat e plagëve në trup, si në dramën e Shekspir. Ju që e njihni ç'ishte letërsia e realizmit socialist e kuptoni se skena të tilla nuk ishin të perfytyrueshme tek ne.

GM: Kohët e fundit shohim që poezia të përkthehet dhe versioni i përkthyer të vihet në krahun e djathtë të versionit origjinal në libër. A mendoni se kjo formë përkthimi është e dobishme apo e padobishme sepse e detyron përkthyesin të përqendrohet më tepër në përkthimin e fjalëve se sa të mendimit të poezisë?

IK: Mendoj se botimet dygjuhëshe janë mjaft të



dobishme për qëllimin për të cilin flisni ju.

GM: A mund të ndodhin që një veprë në përkthim të jetë artistikisht më lart se në origjinal? Nëse po, a është fajtor përkthyesi për një përgënjeshtim sado të vogël ndaj lexuesit, duke i sjellë atij një autor të veshur në një "kostum" artistik që nuk e ka të vetin?

IK: Mund të ndodhë, por tepër rrallë, sidomos në poezi. Në prozë besoj është e pamundur. Në poezi ndodh kur përkthyesi, falë talentit të veçantë të tij, gjendet në rrethana të veçanta, që e bëjnë të mundur këtë paradoks.

GM: Jam i sigurt se e keni lexuar Iliadën në shumë se një gjuhë. Si mendon se është përkthyer rreshti i parë i kësaj veprë të Homerit në gjuhët e botës?

Ju ma bëni këtë pyetje sepse ndoshta keni dëgjuar se në një sprovë ose në një konferencë, s'më kujtohet saktë, kam folur për përkthimin e vargut të parë të "Iliadës", që praktikisht është edhe vargu i parë i poezisë së madhe botërore. Në të vërtetë ky nuk është zbulimi im, por unë kam shtjelluar mendimin e eseistit të shquar shqiptar, Faik Konitzës, i cili, një shekull më parë ka shkruar se ky varg është përkthyer dhe vazhdon të përkthehet krejtësisht gabim, qysh prej dymijë e ca vitesh, në të gjitha gjuhët e botës.

Konitza ishte shkrimtar tepër trillan, që i pëlqenin paradokset, por në këtë konstatim të tij ka plotësisht të drejtë. Ai njihje shumë mirë gjuhët kryesore të Europës, duke përfshirë edhe latinishten dhe greqishten e vjetër. Për të argumentuar mendimin e tij, ai u nis nga njeri prej versioneve frëngjisht të vargut homerik, i cili në anglisht mund të jetë:

Këndo o hyjneshë zemërimin e Akilit, birit të Peleut,
(versioni anglisht në njerin nga përkthimet që i afrohet këtij teksti)

Konitza shkruan se, përveç fjalës "Akil", asgjë s'është e saktë në përkthim. Fjala "këndo", sipas tij, në origjinal është "na trego",

pra më pak emfatike, dhe shumë jetësore, e përditshme. Fjala "hyjneshë", në origjinal është "vajzë", në kuptimin e atyre vajzave që mund të thoshin profecira ose vargje, si punë e rapsodëve, (afron me konceptin muzë, ose zanë). Fjala më e gabuar, sipas Konitzës, është fjala themelore e vargut "zemërimi". Vargu në greqishten e vjetër fillon me këte fjalë: "menin", që është kallzore (kundrinë) e menis, që do të thotë mëri, hidhërim i zgjatur, i thellë, çka është në kundërshtim me "zemërimin", që zakonisht është diçka e shkurtër. Mëria e Akilit zgjat me javë të tëra. Sipas Konitzës, ai është një farë depresioni i thellë. (Gjithmonë sipas Konitzës, nga "menis", fjala kaloi në latinisht në trajtën "mania", e prej latinishtes, në shumicën e gjuhëve, ku tregon pikërisht një lloj obsesioni ose gjendje të sëmurë). I pamëshirshëm siç ishte, Konitza vazhdon se edhe fjalët "bir i Peleut" nuk janë përkthim i saktë, sepse në origjinal thuhet "Akili i Pelejve", pra Akili i fisit, i klanit të Pelejve, dhe për popujt e vjetër të Ballkanit, fisi, klani ishte më i rëndësishëm si identifikim se sa i ati...

Tre përkthyesit e mi më të mirë ...

GM: Cili nga librat tuja mendoni se është përkthimi më i arrirë në cilëndo gjuhë dhe cilat janë veçoritë e përkthimit që e kualifikojnë atë si përkthimi më i mirë?

IK: Tre përkthyes të mi, njeri i gjermanishtes, Joachim Rohm, tjetri i spanjishtes, Ramon Sanchez Lizaralde dhe i treti, David Bellos, kanë marrë çmime. Në gjermanisht dhe spanjisht ka qenë çmimi i vitit i përkthimit, në anglisht ishte "Booker Prize".

GM: Krijimtaria juaj është përkthyer më se 30 gjuhë, në mos gabo. Letërsia juaj e përkthyer në padyshim e ka vënë letërsinë shqipe në hartën e letërsisë botërore. Për këtë kanë një meritë të veçantë jo vetëm përkthyesit e tu por edhe shkrimtarët e tjerë shqiptar që janë tregua të gatshëm të venë publikisht vlerat e punës tuaj mbi

të tyre. Sa keni bërë ju si shkrimtar tashmë i afirmuar botërisht për të nxjerrë në pah shkrimtarët e tjerë shqiptar para botës?

IK: Zgjedhja e librave për përkthim bëhet nga shtëpitë botuese të huaja dhe shkrimtarët shqiptarë nuk luajnë asnjë rol për të vënë dikë në krye të listës apo për ta vënë veten në fund të saj. Asnjë nga librat e mija nuk është caktuar për t'u përkthyer nga asnjë institucion shqiptar. Përkthimi i parë që bëri bujë në botën perendimore, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", u krye prej përkthyesit tim të parë, Jusuf Vrioni, në kushte krejtësisht rastësore. Pas 13 vitesh burg politik, Vrioni, për kënaqësi të vet, më 1964 përkthen romanin tim, ndonëse emri i tij nuk vihej në asnjë libër. Ashtu siç ndodhte në gjithë vendet komuniste, një shtëpi botuese shqiptare përkthente "sukseset e letërsisë shqipe" në gjuhë të huaja, anglisht, frëngjisht, spanjisht, etj. Romanet pak a shumë seriozë, sipas kritikës, përktheheshin. "Gjenerali" tim i erdhi radha të botohej pas pesë vitesh, më 1969. Si gjithë librat e tjerë, ai u botua në Tiranë. Rastësisht ra në duart e një gazetari francez, i cili, pa dijeninë time dhe pa asnjë kontratë ia dha një botuesi parizien.

Mendoj se për kolegët e mi shkrimtarë jam përpjekur. Afërsisht dhjetë libra janë botuar në Francë nga Shqipëria dhe Kosova me interesimin tim. Shumicën e tyre e kam shoqëruar me parathënie prezantuese. Një nga botimet është antologjia voluminoze me gati 600 faqe e 26 autorëve shqiptarë të traditës e të sotmit, botuar më 1978 nga botuesi im francez "Fayard".

Për ta bërë të njohur letërsinë shqipe, kam pranuar vullnetarisht drejtimin e revistës "Les lettres albanaises", që dilte në Tiranë frëngjisht. Në dhjetëra numrat e saj ka mijëra faqe të përkthyer, por vetëm një pjesë e vogël e tyre u ribotua prej botuesve perendimorë. Arsyet merren me mend.

GM: Ndoshta nga të gjitha vendet e botës, Amerika është vendi ku ju jeni më pak i njohur. Deri tani qoftë edhe titujt si "Ismail Kadare: modern Homer o Albanian dissident?" botuar në një nga revistat letrare më prestigjioze në botë, WLT, nuk kanë ndihmuar sa duhet. A ka të bëjë ky fakt me cilësinë e dobët të përkthimit të veprave të tua në anglisht apo me ndonjë arsye tjetër?

IK: Në SHBA besoj se kam rreth 15 tituj të botuar. Jam botuar qysh nga viti 1971 dhe kjo ka qenë tepër befusuese për një shkrimtar që vjen nga një vend i izoluar stalinist. Dihet se njohja e shkrimtarit në botën anglosaksone është më e vështirë se në Europë, megjithatë nuk jam aspak i pakënaqur. Mjafton t'ju them dy shembuj, për t'ju thënë se nuk besoj se Amerika është vendi që njihem më pak. Shumë vite më parë, kur libri im i dytë "Kronikë në gur" u botua në New York, personaliteti i shquar i letrave amerikane John Updake, shkroi një shkrim shumë pozitiv e të ngrohtë në "Newyorker". Më ka prekur shumë ky shkrim për fisnikërinë e tij. Përdora fjalën "fisnikëri" sepse John Updake ishte një shkrimtar shumë më i njohur se unë. Në përgjithësi e kam çmuar gjithmonë gjenerozitetin e shkrimtarëve amerikanë ndaj vëllezërve të tyre. Shembull tjetër për vëmendjen e botës anglofolëse, mendoj se kanë qenë ftesat nga universitetet Columbia e Princeton, nga Bard College si dhe çmimi Booker i vitit 2005.

*Kjo intervistë është botuar këto ditë në anglisht në revistën prestigjioze Translation Review. Kjo revistë për herë të parë në 30 vitet e botimit të saj i është dedikuar me një numër të veçantë letërsisë shqipe të përkthyer në anglisht. Materialet janë zgjedhë dhe redaktuar nga redaktori special i kësaj reviste Gjekë Marinaj. Translation Review është organi zyrtar i ALTA-së (American Literary Translators Association) dhe botohet pranë Qendrës për Studimet e Përkthimit në Universitetin e Teksasit në Dallas (UTD).